



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr.491/1 Prot.

Tiranë, më 17/ 03/ 2021

**V E N D I M**

**Nr. 45, Datë 17 / 03 / 2021**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr.142 Regj, datë 27.11.2020, paraqitur nga ankuesi S.A, kundër Qendrës Shëndetësore Fushë-Krujë dhe Njesisë Administrative Fushë-Krujë, me pretendimin se është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Ankuesi S.A, i datëlindjes 11.10.1960, është banor i Njesisë Administrative Fushë-Krujë. Ai është me gjendje civile i divorcuar dhe është kryefamiljar me aftësi të kufizuar, pasi rezulton se trajtohet me pagesë si invalid pune. Rezulton se ankuesi ka në përbërje familjare djalin i tij të quajtur A.A, i datëlindjes 20.07.1997, i cili gjithashtu është person me aftësi të kufizuar, referuar vërtetimit të lëshuar nga Njësia Administrative Fushë-Krujë.

Në datën 14.12.2019 ankuesi është aksidentuar nga një makinë tek mbikalimi Fushë -Krujë. Nga ky aksident ankuesi deklaron se ka pësuar dëmtime fizike, veçanërisht në pjesën e këmbëve. Në vendin e ngjarjes ka mbërritur policia, e cila e ka hipur në ambulancë dhe është dërguar në urgjencën Fushë –Krujë. Pasi ka marrë ndihmën e parë në urgjencë, në vend që ta dërgonin në spital në Tiranë, e kanë dërguar në shtëpi. Në shtëpi ai ka qenë i vetëm dhe në kushtet që ishte mund edhe të kishte vdekur. Sipas ankuesit, Qendra Shëndetësore Fushë-Krujë, ka fshehur qëllimisht ngjarjen, duke e diskriminuar dhe duke u tallur për shkak të sëmundjes së tij psikike. Ankuesi është dërguar në spital në Tiranë një ditë më vonë, në datën 15.12.2019, ku ka qëndruar deri në datën 27.12.2019. Për trajtimin që ishte ofruar nga shërbimi i urgjencës pranë Qendrës Shëndetësore Fushë-Krujë, ankuesi ka paraqitur ankesë edhe pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por nuk ka marrë asnjë përgjigje në lidhje me këtë ankesë.

<sup>1</sup>Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Sa më sipër, ankuesi pretendon se nuk ka marrë një trajtim korrekt shëndetësor nga ana e urgjencës së Qendrës Shëndetësore Fushë –Krujë.

I ndodhur në një situatë të vështirë ekonomike, por edhe shëndetësore, ankuesi ka kërkuar ndihmë pranë Njesisë Administrative Fushë-Krujë. Ankuesi deklaron se, është përfshirë nga administrata e Njesisë Administrative në listën e personave që do të përfitonin ndihmën e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në kuadër të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, por është hequr në mënyrë të padrejtë nga lista e përfituesve nga ana e Administratorit të Njesisë Administrative. Ankuesi deklaron se nuk ka marrë asnjë ndihmë edhe pse është invalid dhe ishte në gjendje të rënduar për shkak të aksidentit që kishte pësuar.

Ankuesi shprehet se për shkak të kushteve të vështira ekonomike dhe shëndetësore në të cilat ndodhet, që prej muajit dhjetor 2019 është debitor pranë OSHEE, pasi nuk ka mundësi financiare që të paguajë.

Ai deklaron se ndihet i diskriminuar për shkak sëmundjes psikike nga e cila vuan, dhe i ndodhur në kushte të vështira ekonomike dhe shëndetësore, kërkon që të trajtohet me ndihmë nga Njësia Administrative Fushë-Krujë.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Shkaku i diskriminimit i pretenduar nga ankuesi, *aftësia e kufizuar*, është shkak i mbrojtur nga neni 1, i ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Bazuar në nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në nenin 20, pika 1 dhe pika 2, germat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: .....b) mundësi për të marrë ose për të përfituar nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin; .....c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;.....”*

Ankesa e paraqitur ishte në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekzistojnë, asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD.

Në kuadër të procedurava të parashikuara nga ligji për shqyrtimin e ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se : *“8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”* Komisioneri vendosi të zhvillojë një seancë dëgjimore, me qëllim sqarimin e fakteve dhe rrethanave të çështjes.

Seanca dëgjimore ishte planifikuar për t'u zhvilluar në datë 16.02.2021 ora 11:00. Njoftimi i palëve për datën dhe orën e përcaktuar për zhvillimin e seancës dëgjimore u realizua me shkresën nr. 239 prot., datë 03.02.2020. Bazuar në lajmërim marrjet e shërbimit postar, rezulton se të gjitha palët e përfshira në procedurën administrative kanë marrë rregullisht dijeni.

Në datën 15.02.2021, një ditë para zhvillimit të seancës dëgjimore, Komisioneri u bë me dije nga Njësia Administrative Fushë–Krujë se, ankuesi S.A, kishte ndërruar jetë si pasojë e një infarkti në zemër. Seanca dëgjimore nuk u zhvillua, pasi në datën dhe orën e përcaktuar për zhvillimin e seancës dëgjimore, nuk u paraqit asnjë nga palët.

Me shkresën nr. 249/1 prot., datë 24.02.2021, Njësia Administrative Fushë – Krujë, vuri në dispozicion certifikatën e vdekjes me nr. 016178763, lëshuar në datë 16.02.2021, nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Fushë-Krujë, sipas të cilës rezultoi se ankuesi S.A, ka ndërruar jetë në datë 09.02.2021, dhe shkak i vdekjes është “*sëmundje acute e zëmres dhe të mushkërive*”.

Në nenin 33, pika 3, të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.*”

Ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, nuk ka parashikuar procedura në lidhje me situatat kur personi që ka vënë në lëvizje Komisionerin nëpërmjet paraqitjes së ankesës, ka ndërruar jetë. Për rrjedhojë, në mungesë të procedurave të parashikuara në ligjin e posaçëm dhe bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore, Komisioneri referon në parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

Në nenin 90, të Kodit të Procedurave Administrative parashikohet se: “*1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, përfundon me një vendimmarrje përfundimtare për çështjen, përkatësisht një akt administrativ apo një kontratë administrative. Në vendimin përfundimtar për çështjen, organi publik vendos për të gjitha çështjet e ngritura nga palët gjatë procedurës dhe që nuk kanë marrë zgjidhje gjatë tij. 2. Përfundimi i procedurës administrative, të nisur kryesisht, është në diskrecion të organit publik, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji. 3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ.*

Në nenin 93, të Kodit të Procedurave Administrative parashikohet se: “*1. Nëse pala, person fizik, vdes gjatë zhvillimit të procedurës administrative që zhvillohet për një çështje të karakterit personal, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative, pa marrë një vendim përfundimtar për çështjen. Në çdo rast tjetër, nëse organi publik vlerëson nëse pjesëmarrja e palës është e domosdoshme, pezullon procedurën për kohësisht deri në identifikimin e trashëgimtarëve. 2. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, edhe në rastin e mbarimit të personit juridik, kur ky i fundit është palë, organi publik deklaron përfundimin e procedurës administrative pa marrë një vendim përfundimtar.*

Në rastin konkret, procedura administrative është nisur me kërkesë të ankuesit S.A. Komisioneri vlerëson se, çështja objekt shqyrtimi në këtë procedurë administrative, ka karakter personal.

Bazuar në rregullimin e mësipërm ligjor, Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 142 Regj., datë 27.11.2020, e nisur me kërkesën e ankuesit S.A, duhet të deklarohet e përfunduar, pa një vendim përfundimtar për çështjen, për

shkak se ankuesi ka ndërruar jetë gjatë zhvillimit të procedurës administrative për shqyrtimin e ankesës.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenet 32/1/a, 32/3 dhe 33 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenet 90/3 dhe 93, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr.142 Regj., datë 27.11.2020, të paraqitur nga ankuesi S.A kundër Njësisë Administrative Fushë-Krujë dhe Qendrës Shëndetësore Fushë-Krujë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Aftësia e kufizuar  
Fusha: Shërbime  
Lloji i vendimit: Përfundim i procedurës pa vendim përfundimtar